



Влада на Република Северна Македонија

Në bazë të nenit 19 paragrafi (7) të Ligjit doganor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 39/05, 4/08, 35/10, 48/10, 158/10, 44/11, 53/ 11, 11/12, 171/12, 187/13, 15/15, 129/15, 154/15, 192/15, 23/16, 144/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më -----të vitit 2023, miratoi

PROPOZIM - VENDIM PËR ULJEN E TAKSAVE TË IMPORTIT PËR IMPORTIN E PEMËVE TË FRESKËTA

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohet masa për heqjen e taksës së importit – normë doganore dhe taksa të veçanta gjatë importit të pemëve të freskëta edhe atë:

Shenja tarifore	Përshkrim	Norma doganore (BO %)
0703	Qepë, alma, hudhër, presh dhe hudhëra të tjera, të freskëta ose të ftohura:	
0703 10	- Qepë dhe alma:	
	-- Qepë:	
	--- Tjetër:	
0703 10 19 90	---- Nga 01 tetori deri më 31 mars	10
0703 90	- Presh dhe hudhëra të tjera:	
0703 90 00 90	-- Tjetër	10
0704 10	- Lulelakër dhe brokoli:	
0704 10 10 00	-- Lulelakër dhe brokoli kokëqepe (headed broccoli)	10
0705	Sallatë (<i>Lactuca sativa</i>) dhe cikorinë (<i>Cichorium spp.</i>), të freskëta ose të ftohura:	
	- Sallatë:	
0705 11 00 00	-- Sallatë me kokë	10
0705 19 00 00	-- Tjetër	10
0706	Karota, pjeshkë ose panxhar djerirnë (panxhar i bardhë), panxhar,	



Влада на Република Северна Македонија

0706 10 00 00	selino, perime me rrënjë, rrepka dhe perime të ngjashme me rrënjë për ushqim, i freskët ose i ftohur: - Karota, pjeshkë ose panxhar djerrinë (panxhar i bardhë)	10
0709	Perime të tjera, të freskëta ose të ftohura:	
0709 30 00	- Patëllxhan	10
0709 93	-- Kunguj, kunguj të vegjël dhe kunguj dekorimi (Cucurbita spp.):	
0709 93 10 00	--- kunguj të vegjël	10
0709 99	-- Tjetër:	
0709 99 10 00	--- Perime për sallatë, përveç sallatës së gjelbër (Lactuca sativa) dhe rrënjë të ëmbël (Cichorium spp.)	10

Neni 2

Mallrat nga neni 1 i këtij vendimi, do të importohen deri më 28 shkurt të vitit 2024.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi ne ditën e nesërme nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. _____ ____shtator të vitit 2023 Shkup		Kryetar u Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, dr. Dimitar Kovačevski, n.p.
---	--	---



Влада на Република Северна Македонија

A r s y e t i m

Me këtë vendim propozohet ulje e përkohshme e taksave të importit – normave doganore dhe taksave të veçanta gjatë importit të perimeve të freskëta edhe atë:

- Qepë
- Presh
- Lulelakër dhe brokoli
- Sallatë me kokë
- Tjetër sallatë
- Karota, pjeshkë ose panxhar djerrinë
- Patëllxhan
- Kunguj të vegjël
- Perime për sallatë, përveç sallatës së gjelbër

Propozim vendimi për uljen e taksave të importit – normave doganore dhe taksave të veçanta për importin e perimeve të freskëta, propozohet me qëllim të uljes së çmimeve të këtyre produkteve në vend dhe mbrojtjes së standardit jetësor të qytetarëve.

Normat e rregullta doganore të këtyre produkteve variojnë deri në maksimum 55% dhe 65% (qepë), 45 % (presh), 40% (karota), 35% (lulelakra, brokoli, kungull i njomë dhe patëllxhan) dhe 30% (sallatë koke dhe sallatë të tjera). Importi i këtyre produkteve bëhet pa doganë nga vendet anëtare të CEFTA-s dhe me doganë të paguar nga vendet e tjera.

Importi i këtyre produkteve bëhet pa doganë nga vendet anëtare të CEFTA-s dhe me doganë të paguar nga vendet e tjera.

Në përputhje me të dhënat e dorëzuara nga Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën nga 1 tetori i vitit 2022 deri më 28.02. të vitit 2023, është realizuar import i përgjithshëm i këtyre produkteve në vlerë prej 181.724.902 denarë, përkatësisht import dhe eksport preferencial prej 73.186.204 denarë dhe import jopreferencial, përkatësisht import me doganë të paguar eksporti prej 108.538.698 denarë.

Me këtë rast është arkëtuar doganë në vletë prej 24.090.740 denarë dhe TVSH në vlerë prej 10.418.730 denarë.

Në përputhje me simulimin e bërë nga Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nëse do të merrej ky vendim, do të arkëtohej dogana në vlerë të përgjithshme prej 11.243.398 denarë dhe TVSH në vlerë prej 9.955.379 denarë ose gjithsej 21.198.777 denarë, në periudhën nga 1 tetori i vitit 2022 deri më 28.02. të vitit 2023.



Влада на Република Северна Македонија

Implikimet fiskale sipas këtij simulimi do të ishin 12.847.342 denarë më pak doganë të arkëtuar dhe 463.351 denarë më pak TVSH.

